# Policia e Republikës së Kosovës

## "Siguria si sfidë kyçe për transport të qëndrueshëm dhe mobilitet"




**Prishtinë, 20 Janar 2017**

# Konferenca e 4-të Ndërkombëtare

" Politikat qeveritare dhe planet e veprimit
për mobilitet në trafik si parametra kryesor
që përcaktojnë sigurinë e lëvizjes
në trafikun rrugor “

**PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK 2011 – 2015, I POLICISË SË RKS-së**

**PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK 2016 – 2020, I POLICISË SË RKS-së**

**Objektivi Strategjik numër 1, në objektivin specifik numër 1.2 përfshinë ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor dhe parandalimin e aksidenteve.**

- ❑ **STRATEGJITË E QEVERISË DHE INSTITUCIONEVE TJERA QË KANË TË BËJNË ME FUSHËN E TRAFIKUT**
- ❑ **STRATEGJINË E SIGURISË RRUGORE DHE PLANIN E VEPRIMIT 2016 – 2020, MI**
- ❑ **STRATEGJINË SEKTORIALE DHE TRANSPORTIT MULTIMODAL 2015 -2025, MI**
- ❑ **STRATEGJITË, REKOMANDIMET, DIREKTIVAT APO TË NGJASHME, QOFTË ATO TË BE-së APO OKB-së, DHE**
- ❑ **LIGJET DHE DOKUMENTET TJERA QË RREGULLOJNË DHE KANË TË BËJNË ME TRAFIKUN RRUGOR**

# Siguria në trafikun rrugor

Me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafikun rrugor, Policia e Kosovës, vetëm në vitin **2016**, ka:

- Hartuar dhe implementuar 150 plane operative;
- Identifikuar dhe adresuar dukuritë negative në trafik, duke përfshirë infrastrukturën rrugore, vendet e rrezikshme/pikat e zeza, shkaktarët e aksidenteve të trafikut rrugor;
- Marrë pjesë në **16** konferenca, **181** takime, **33** grupe punuese/komisione, lidhur me trafikun rrugor;
- Pjesëmarrja mbi **133** emisione televizive, siguria në trafik;
- Mbi **181** ligjërata në institucionet shkollore, siguria në trafik;
- Vlen të theksohet se viti 2016 krahasuar me vitin 2015, është karakterizuar me:
  - *ngritjen* e numrit të përgjithshëm të aksidenteve në trafikun rrugor për **4.62 %,**
  - *ngritjen* e numrit të aksidenteve me lëndime për **16.21 %,**
  - *ngritjen* e numrit të aksidenteve me dëme për **10.47 %,** si dhe
  - *rënien* e aksidenteve fatale për **-15.38** %.

# Numri i përgjithshëm i aksidenteve të trafikut rrugor 2011-2016




**2011/2016 = - 1.83%**

## Numri i aksidenteve fatale dhe me persona që kanë humbur jetën 2011-2016




**AF 2011/2016 = - 24 %**
**PV 2011/2016 = - 30 %**

## Numri i aksidenteve me lëndime dhe me persona të lënduar 2011- 2016




**AL 2011/2016 = 36%**
**PL 2011/2016 = 44 %**

| Shtetet | Shqipëria | Mal i Zi | Bosnja | Serbia | Greqia | Maqedonia | Kosova |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Të vdekur për 100,000 banorë | 20.4 | 10.4 | 8.7 | 7.5 | 7.4 | 6.9 | 6.9 |



## Road deaths per million inhabitants - Preliminary country by country statistics for 2015




| | 2010 | 2014 | 2015 | 2014 - 2015 | 2010 - 2015 |
|---|---|---|---|---|---|
| Belgium | 77 | 65 | 67 | 4% | -10% |
| Bulgaria | 105 | 91 | 95 | 4% | -12% |
| Czech Republic | 77 | 65 | 70 | 7% | -8% |
| Denmark | 46 | 32 | 30 | -8% | -35% |
| Germany | 45 | 42 | 43 | 3% | -5% |
| Estonia | 59 | 59 | 50 | -15% | -16% |
| Ireland | 47 | 42 | 36 | -15% | -22% |
| Greece | 112 | 73 | 74 | 2% | -36% |
| Spain | 53 | 36 | 36 | 0% | -32% |
| France | 64 | 53 | 54 | 2% | -13% |
| Croatia | 99 | 73 | 82 | 13% | -18% |
| Italy | 70 | 56 | 56 | 1% | -17% |
| Cyprus | 73 | 52 | 66 | 27% | -5% |
| Latvia | 103 | 106 | 94 | -11% | -14% |
| Lithuania | 95 | 91 | 82 | -10% | -19% |
| Luxembourg | 64 | 64 | 58 | -9% | 0% |
| Hungary | 74 | 63 | 66 | 3% | -13% |
| Malta | 36 | 24 | 26 | 10% | -27% |
| Netherlands | 32 | 28 | 28 | 0% | -12% |
| Austria | 66 | 51 | 56 | 10% | -14% |
| Poland | 102 | 84 | 77 | -8% | -25% |
| Portugal | 80 | 61 | 60 | -2% | -33% |
| Romania | 117 | 91 | 95 | 4% | -21% |
| Slovenia | 67 | 52 | 58 | 11% | -13% |
| Slovakia | 65 | 48 | 51 | 6% | -22% |
| Finland | 51 | 42 | 48 | 15% | -3% |
| Sëeden | 28 | 28 | 27 | -2% | 0% |
| United Kingdom | 30 | 29 | 29 | -1% | -4% |
| **EU** | **63** | **51** | **51.5** | **1%** | **-17%** |
| RKS | 97 | 74 | 74.5 | 0.7% | -23% |

## Krahasimi i aksidenteve në Kosovë për Janar - Dhjetor 2015/2016

| Janar-Dhjetor 2015 | | | Janar-Dhjetor 2016 | | ( +/- ) | % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Aksidente fatale | 117 | | Aksidente fatale | 99 | -18 | -15.38 |
| Persona të vdekur | 129 | | Persona të vdekur | 110 | -19 | -14.73 |
| | | | | | | |
| Aksidente me lëndime | 5275 | | Aksidente me lëndime | 6130 | 855 | 16.21 |
| Personat e lënduar | 10671 | | Personat e lënduar | 12009 | 1338 | 12.54 |
| | | | | | | |
| Aksidente me dëme | 11145 | | Aksidente me dëme | 12312 | 1167 | 10.47 |
| | | | | | | |
| Godit dhe ik | 1185 | | Godit dhe ik | | / | / |
| | | | | | | |
| Total aksidente | 17722 | | Total aksidente | 18541 | 819 | 4.62 |
| | | | | | | |
| Tiketa të shqiptuara | 303971 | | Tiketa të shqiptuara | 326515 | 22544 | 7.42 |

| Shkaktarët e aksidenteve të komunikacionit rrugor për periudhën kohore "Janar – Dhjetor 2016" | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **2016** | % |
| **Manovrimi i pasigurt me automjet/pa u bindur që mund ta kryej veprimin** | 4265 | 23 |
| **Mos mbajtja e distancës** | 3069 | 16.6 |
| **Mos përshtatja e shpejtësisë ndaj kushteve te rrugës/klimatike** | 2490 | 13.4 |
| **Kyçje e pasigurt në rrugë** | 1338 | 7.2 |
| **Kthim-rrotullimi lëvizja mbrapa** | 1200 | 6.5 |
| **Radhitje e pa rregullt-ndërrimi i shiritave** | 1198 | 6.5 |
| **Anashkalim dhe tejkalim i pa rregullt** | 879 | 4.7 |
| **Mos respektimi i përparësisë së kalimit** | 796 | 4.3 |
| **Dalja/Hyrja nga parkingu** | 508 | 2.7 |
| **Tejkalim i shpejtësisë së kufizuar** | 416 | 2.2 |
| **Mos respektimi i shenjave të komunikacionit** | 413 | 2.2 |
| **Drejtimi nën ndikimin e alkoolit/drogës** | 111 | 0.60 |
| **Ngasja e automjetit në anën e gabuar** | 87 | 0.47 |
| **Parking i pa rregullt** | 83 | 0.44 |
| **Dalja nga rruga** | 77 | 0.41 |
| **Mbingarkesa-ngarkesa e pa rregullt në automjet** | 34 | 0.18 |
| **Ngadalësimi / frenimi i vrullshëm** | 20 | 0.10 |
| **Mos posedimi i patentë shoferit** | 16 | 0.08 |
| **Kalimi i rrugës në vendkalim për këmbësorë** | 12 | 0.06 |
| **Gjendja shëndetësore - (sëmundja-lodhja)** | 8 | 0.04 |
| **Të tjera** | 1463 | 7.9 |
| **Total** | **18483** | |

AKSIDENTE FATALE DERI

0.53%

AKSIDENTE ME LËNDIME

33%

AKSIDENTE ME DËME

66%




Për të arritur këtë rekomandim në Republikën e Kosovës numri i personave të vdekur në vitin 2020 duhet të bie në 78.

Bazuar në të dhënat e një hulumtimi gjithëpërfshirës të kryer nga Divizioni i Trafikut Rrugor në vitin 2016, në lidhje me sigurinë në trafikun rrugor, konstatohet se numri i fataliteteve të shkaktuara si pasojë e aksidenteve rrugore, për **1 milion banorë** në Kosovë për vitin 2016 ka qenë **63**.

## Projektet (*fushatat*) vetdijësuese

- ″Kujdes se po rrëshqet″
- “Çdo këmbësor është i rëndësishëm, jini të kujdesshëm″
- “Shkaktarët më të shpeshtë të aksidenteve″
- “Kodi i gjelbër i fëmijëve″
- “Ligjërata në institucione parashkollore dhe shkollore″
- “Siguria rrugore – përgjegjësi për të gjithë″
- “Aktivitetet për shënimin e ditës botërore të përkujtimit të viktimave të trafikut rrugor″
- Spotet televizive: “Shpejtësia″, “Këmbësorët″, “Telefoni″
- “Kujdes! Çmoje Jetën!″.

**Konferenca Ndërkombëtare "Dita botërore e përkujtimit të viktimave të trafikut rrugor, 20.11.2016, Prishtinë**









# ELMI FAZLIU



# RENEA BEHLULI

[redacted]

Drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit dhe përdorimi i telefonit gjatë drejtimit mund të ndërpresin jetë. Duaje jetën tënde dhe respekto jetën e tjetrit!

Shfrytëzo vendkalimet për këmbësorë dhe ec nëpër trotuare. Në rrugët pa trotuare, ec në anën e majtë! Shiko majtas e djathtas dhe mos u ngut! Kujdesi shpëton jetë!

TEMPULLI

# KUJDES! ÇMOJE JETËN!

## Aksidentet nuk ndodhin, ato shkaktohen!



Shpejtësia është shkaktari më i madh i aksidenteve në trafik. Ajo vret! Mos shpejto.E ke vetëm një jetë!

Në çdo automjet, në çdo udhëtim, rripi i sigurisë dhe ulësja për fëmijë mund të shpëtojnë jetë. Vendosja e rripit të sigurisë dhe ulëses për fëmijë janë të obliguara me ligj!

"*Thënia "një çast mund ta ndryshoj të ardhmen" tani më është kalitur në mendje, sepse pikërisht kështu ndodhi me mua.*
*Si 17 vjeçar, në kohën më të mirë të rinisë, u gjenda në vend të gabuar, në një veturë të shpejtë me shofer pa patent, të pakujdesshëm dhe që nuk respektonte pothuajse asnjë shenjë të trafikut. Asnjëri nga tre shokët nuk kishim vënë rripin e sigurisë. Nga tejkalimet e shpejta humbëm kontrollin dhe u aksidentuam.*
*Edhe pse isha ulur prapa, lëndimet e mia ishin të tmerrshme dhe me pasoja të përjetshme. Tani ishte vonë për kujdes, gjithçka ndryshoj përgjithmonë!*
*Aksidenti ndodhi derisa po bëja plane për të ardhmen. Merresha me sport, dhe shkollohesha që një ditë të bëhem polic trafiku.*

*Nëntë vite më pas, ende ballafaqohem me sfida te mëdha shëndetësore, shpirtërore, dhe emocionale, por përkundër të gjithave, jam munduar t'i kthehem jetës time si çdo person tjetër. Tani jam student i shkencave kompjuterike dhe qe tre vite, shofer i kujdesshëm në trafik.*

*Sot, ju bëj apel të gjithëve të kontribuojnë për siguri më të madhe në rrugë, sepse nesër mund të jetë shumë vonë!*

Elmi Bazini



"*Koha është të mendojmë!*

*Jetën e Milot Bajramit, shokut tim të mirë Milit, nuk e kthen askush...fatkeqsisht. Jeta e Milit u shua në prehrin tim për shkak të një të riu i cili ishte duke vozitur veturën e tij të shtrenjtë me shpejtësi të madhe në mes të Prishtinës, në gjendje të dehur.*
*Nëse ai i ri do t'i mendonte pasojat që do t'i kete vozitja në gjendje të dehur, Mili ndoshta do të ishte gjallë. Nëse ai i ri do t'i mendonte pasojat e vozitjes me shpejtësi më të lartë se që ishte e lejueshme, Mili ndoshta do të ishte gjallë. Nese ai i ri që e ka marrë jetën e Milit gjykohet shpejt dhe drejt, ndoshta për të afërmit e Milit kjo dhimbje do të lehtësohej sadopak.*

*Jam e bindur se nëse të gjithë ne do t'i mendonim pasojat e pakujdesive tona në trafik, do të ulej numri i viktimave të trafikut...dhe rrjedhimisht do t'i kursenim shumë njerëz nga vuajtja, dhimbja e pikëllimi.*

*TASH është koha që të mendojmë!*

Ronea Bekiri



Policia e Kosovës
Policija Kosova
Kosovo Police

## ÇDO KËMBËSOR ËSHTË I RËNDËSISHËM, JINI TË KUJDESSHËM!

2015
50

2016
25

TË NDERUAR, PËR TË ... SIGURT NË RRUGË POLICIA E KOSOVËS APELON ... TË RESPEKTOHEN RREGULLAT DHE SHENJAT E KOMUNIKACIONIT RRUGOR, NË VEÇANTI KJO FUSHATË U DEDIKOHET KËMBËSORËVE.

-25 apo -50%



Persona që kanë humbur jetën sipas pjesmarrësve në komunikacionin rrugor për vitin 2015



JINI TË KUJDESSHËM NË PARKING



Këmbesorë që kanë humbur jetën sipas kohës (ditë & natë) për vitin 2015



Këmbesorë që kanë humbur jetën sipas kategorive të rrugëve për vitin 2015



TËRHIQNI KUFJET DHE KUSHTONI VËMENDJE ECJES NË RRUGË



KUR TË ZBRITNI NGA AUTOBUSI, KALONI RRUGËN MBRAPA TIJ ME KUJDES



NËSE KËMBËSORI LËVIZ RRUGËS DUHET TË LËVIZË NË ANËN E MAJTË TË RRUGËS



KUR KËMBËSORËT E KALOJNË HEKURUDHËN, DUHET TA BËJNË ME KUJDESIN MË TË MADH. NUK DUHET TË ECIN PËRGJATË HEKURUDHËS DHE TË KALOJNË MBI BINARË NËSE DRITA E KUQE ËSHTË E NDEZUR OSE PENGESA ËSHTË E LËSHUAR



KËMBËSORËT GJATË KALIMIT TË RRUGËS OBLIGOHEN QË TË SHFRYTËZOJNË VENDKALIMET E KËMBËSORËVE, KU ATO EKZISTOJNË



VISHNI RROBA TË NDRITSHME OSE MBANI ME VETE MATERIAL REFLEKTUES APO DRITË TË BARDHË GJATË NATËS, PËR T'IU NDIHMUAR JUVE DHE NGASËSVE QË T'JU SHOHIN



FËMIJËT E SHOQËRUAR NGA PRINDËRIT E TYRE GJITHMONË DUHET TË ECIN NË ANËN E SIGURT TË RRUGËS, DUKE IU SHMANGUR KËSHTU ANËVE TË RRUGËS AFËR TRAFIKUT



PËR TË QENË ME TË SIGURT ECNI ME KUJDES TË SHTUAR NË RRUGË

Përgatiti:
Drejtoria për Preventivë në Komunikacionin Rrugor
Divizioni i Komunikacionit Rrugor

Dizajni: ZIMP

Telefoni: 192

info@kosovopolice.com
facebook.com/kosovopolicezimp
www.kosovopolice.com



Këmbesorë që kanë humbur jetën sipas grup-moshës për vitin 2015

KËMBËSORËT DUHET TË ECIN NË VENDET QË JANË TË CAKTUARA PËR KËMBËSORË, E TË CILAT JANË TROTUARE. NËSE NUK KA TROTUARE OSE RRUGË TË SHTRUAR PËR KËMBËSORË, ATA DUHET TA MBAJNË ANËN E MAJTË TË RRUGËS, NË MËNYRË QË TË MUND TA SHOHIN KOMUNIKACIONIN QË VJEN DREJT TYRE. NËSE JANË NË GRUPE, KËMBËSORËT DUHET TË ECIN NJËRI PAS TJETRIT

## Lëvizja e mjeteve motorike në zonat e shkollës

Shpejtësia më e madhe e lejuar në zonën e shkollës prej orës 07:00 deri në ora 20:00 është:




- brenda zonës urbane 30 (km/h)
- jashtë zonës urbane 50 (km/h)

Dënohet për kundërvajtje:

- me gjobë prej 150 € deri në 450 € personi fizik i cili vepron ndryshe;
- me gjobë prej 2,000 € deri në 6,000 € edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit ka vepruar personi.

## Lëvizja e veturave në trafikun i cili rregullohet me semafor



Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej 150 € shoferi i cili nuk ndalet në shenjën e dritës së kuqe në vendin ku trafiku rregullohet me semaforë.
Shoferit i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej 3 muajsh, si dhe 3 pikë negative.

www.kosovopolice.com

## Lëvizja e këmbësorëve

Këmbësori është i detyruar që ta përdorë trotuarin dhe shtegun për këmbësorë. Këmbësori mund ta përdorë rrugën qarkulluese duke lëvizur sa më afër skajit të rrugës dhe nëse nuk e pengon trafikun.
- Gjatë kalimit të rrugës, të shiritit apo të shtegut të biçikletave ose të binarëve, këmbësorit nuk i lejohet përdorimi i telefonit mobil, shfrytëzimi i dëgjueseve në veshë apo i pajisjeve të tjera të ngjashme që mund ta hutojnë.



- Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 20 € personi i cili vepron në kundërshtim me këto rregulla.
Ndalohet shfrytëzimi i trotuarit për aktivitete tjera përveçse për lëvizje të këmbësorëve.
- Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 40 € këmbësori i cili vepron ndryshe.

## Lëvizja e këmbësorëve jashtë zonës urbane

Këmbësori i cili lëvizë jashtë zonës urbane duhet ta shfrytëzojë anën e majtë të rrugës. Në kushte të dukshmërisë së ulët, duhet të mbajë ndonjë mjet, pajisje reflektuese apo burim drite.
- Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 20 € këmbësori i cili vepron ndryshe.
Në rrugë jashtë zonës urbane fëmija deri në moshën 7 vjeç lejohet ta shfrytëzojë rrugën vetëm nën mbikëqyrje të personit që është së paku i moshës 10 vjeçe.
- Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 40 € prindi ose kujdestari nëse fëmija vepron në kundërshtim me ligjin.



## Shpejtësia e lëvizjes brenda zonës urbane

Shpejtësia më e madhe e lejuar brenda zonës urbane është 50 km/h, nëse nuk është e përcaktuar ndryshe.




Dënohet për kundërvajtje:

- me gjobë prej 300 € deri në 900 € shoferi i cili lëvizë me shpejtësi mbi 50 km/h mbi shpejtësinë e lejuar, si dhe i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit së paku 1 vit dhe 5 pikë negative;
- me gjobë prej 200 € deri në 600 € shoferi i cili lëvizë me shpejtësi prej 30 km/h deri në 50 km/h mbi shpejtësinë e lejuar, si dhe i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit 6 deri në 12 muaj dhe 3 pikë negative;



- me gjobë prej 60 € shoferi i cili brenda zonës urbane lëvizë me shpejtësi prej 20 km/h deri në 30 km/h mbi shpejtësinë e lejuar;
- me gjobë prej 40 € shoferi i cili lëvizë me mjet prej 10 km/h deri në 20 km/h mbi shpejtësinë e lejuar;



- me gjobë prej 20 €, shoferi i cili lëvizë prej 5 km/h deri në 10 km/h mbi shpejtësinë e lejuar.




## Ulësja e sigurisë për fëmijë

Fëmijët nën moshën 12 vjeç dh
me lartësi nën 150 cm. duhet
jenë të siguruar tërësisht ap
pjesërisht me sistem të sigu
domethënë me ulëse të siguris
për fëmijë.

- Dënohet për kundërvajtje m
gjobë prej 100 € deri në 300
shoferi i mjetit i cili vepron ndr
she, si dhe i shqiptohet mas
mbrojtëse ndalim i të drejtuarit
mjetit në kohëzgjatje prej 3 de
në 6 muaj.



Fëmija nën përkujdesje të pe
sonit të moshës madhore, që nu
është i ulur në ulëset e përparm
të mjetit, nëse mbahet në preh
apo në duar të këtij personi, lir
het nga detyrimi për ta përdor
ulësen e sigurisë për fëmijë.

## Rregullat e trafikut për biçiklistë

Biçiklisti duhet ta shfrytëzojë shiritin për biçikleta ose shtegun e përbashkët për biçikleta dhe këmbësorë. Kur nuk ekziston shtegu duhet ta shfrytëzojë shiritin e djathtë, sa ma afër skajit të rrugës.



- Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 20 € biçiklisti i cili vepron ndryshe.

Fëmijëve më të ri se 12 vjeç nuk iu lejohet ta drejtojnë biçikletën në rrugë publike. Fëmija i cili ka mbushur 9 vjet mund ta drejtojë biçikletën në zonat e këmbësorëve, në zonën e trafikut të qetë, në zonën me kufizim të shpejtësisë në 30km/h, në zonën e shkollës dhe në rrugët e pakategorizuara. Në zonën e këmbësorëve dhe në zonën e trafikut të qetë biçikletën mund ta drejtojë fëmija më i ri se 9 vjeç nëse është nën mbikëqyrje të personit mbi 16 vjeç.



- Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 20 € prindi ose kujdestari nëse biçiklisti vepron ndryshe.

Biçiklisti është i detyruar të ketë jelek reflektues, rroba reflektuese apo ndonjë burim drite në rrugët me dukshmëri të zvogëluar. Biçiklisti më i ri se 16 vjeç duhet ta mbajë helmetën mbrojtëse gjatë drejtimit të biçikletës.

- Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 20 € biçiklisti i cili vepron ndryshe.

## Ndalimi i përdorimit të alkoolit

Shoferi dënohet për kundërvajtje:

- me gjobë prej 100 € deri në 300 € nëse në organizëm ka alkool deri në 0,50 g/kg, si dhe i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit në kohëzgjatje prej 3 deri në 6 muaj dhe 1 pikë negative;
- me gjobë prej 150 € deri në 450 € nëse në organizëm ka alkool mbi 0,50 deri në 1,00 g/kg, si dhe i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit në kohëzgjatje prej 6 deri në 12 muaj dhe 2 pikë negative;
- me gjobë prej 200 € deri në 600 € nëse në organizëm ka alkool mbi 1,00 deri 1,50 g/kg, si dhe i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit në kohëzgjatje prej 9 deri në 18 muaj dhe 2 pikë negative;



- me gjobë prej 300 € deri në 900 € nëse në organizëm ka alkool mbi 1,50 g/kg, si dhe i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit në kohëzgjatje prej 1 deri në 2 vjet dhe 3 pikë negative;

## Anulimi i patentë shoferit

Shoferit të cilit i janë shqiptuar 9 pikë negative, i ndalohet drejtimi i mjetit prej 3 deri në 24 muaj. Shoferi i cili ka 9 pikë negative dhe masën e ndalimit të drejtimit të mjetit dhe të njëjtit i shqiptohen edhe 9 pikë tjera negative, i anulohet patentë shoferi për të gjitha kategoritë.
Shoferi ka të drejtë t'i nënshtrohet përsëri provimit për patentë shoferi si kandidat fillestar pas 2 vjetëve.

## Masa mbrojtëse për patentë shoferi të huaj

Shoferit i cili posedon patentë shoferi të një vendi të huaj dhe i cili bën kundërvajtje në trafik mund t'i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i shfrytëzimit të patentë shoferit të huaj në territorin e Republikën e Kosovës në kohëzgjatje prej 3 muajsh deri në 2 vjet.
Personi i autorizuar mund t'ia marrë shtetasit të huaj përkohësisht pasaportën, gjegjësisht ndonjë dokument tjetër, në kohëzgjatje deri në 3 ditë



## Sjellja e pjesëmarrësit në aksident të trafikut

Shoferi apo pjesëmarrësi tjetër i përfshirë në aksident të trafikut, e ka për detyrë ta ndalë mjetin, të ndërmarrë gjithçka që është e mundur dhe ta njoftojë Policinë.
Shoferi i cili është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në aksident dhe i cili largohet me mjet nga vendi i aksidentit dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 300 € - 900 € dhe me së paku 1 vit ndalim i drejtimit të mjetit motorik dhe 5 pikë negative.



## Raporti Evropian i Aksidentit

Shoferi i mjetit i cili nuk e pose don me vete Raportin Evropiar të Aksidentit dënohet me gjobë 50 €




Me gjobë prej 500 € deri 1500 € dënohet institucioni i autorizuar cili me rastin e sigurimit të mjetit pronarin e mjetit nuk e pajis me Raportin Evropian të Aksident eve.



## Pagesa e gjobës në trafik

Kundërvajtësi i cili e paguar gjobën në të holla brenda ditësh do ta paguajë vetën gjysmën e gjobës së parapare për kundërvajtjen e shkaktuar.
Nëse kundërvajtësi nuk e paguar gjobën në afatin prej 8 ditësh, fil lon procedurë përmbarimore apo kundërvajtëse pranë institucioni përkatës.

Organization for Security and Co-operation in Europe
Mission in Kosovo

## GOMAT

Gomat e dimrit

- Përdorë gomat e dimrit që mbajnë shenjën M+S, M.S ose M&S.

**Këto goma ofrojnë tërheqje dhe kontroll më të mirë në kushte të ndryshme dimërore, veçanërisht kur udhëtohet në baltë apo borë.**

Presioni i gomave

- Fryni gomat në mënyrë të drejtë, që puthitja (kapja) e tyre të jetë sa më e mirë duke siguruar distancën e frenimit dhe manovrimin e sigurt.

**Temperaturat e ftohta të dimrit zakonisht e ulin presionin e gomave.**

- Ndiq rekomandimet e presionit të gomave në manualin e prodhuesit të mjetit.

## NDRIÇIMI

- Kontrollo të gjitha sistemet e ndriçimit, dritat kryesore të shkurtra apo të gjata, indikatorët dhe dritat e pasme, të cilat mund të errësohen nga bora dhe akulli.

Referuar ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor:

- Për kundërvajtje me gjobë prej 200.00 deri 550.00 euro, dënohet operatori transportues që urdhëron ose lejon mjetin pa pajisje dimërore në rrugë.
- Për kundërvajtje me gjobë prej 35.00 euro, dënohet shoferi që drejton mjetin pa pajisje dimërore.

Policia e Kosovës

www.kosovopolice.com
www.facebook.com
KosovoPoliceZIMP
zimp@kosovopolice.com
Numrat kontaktues 192/922

Asociacioni Kosovar i Motorizimit AMRKS

www.amrks.org
www.facebook.com/pages
AMRKS/394168837354328
Email: info@amrks.org

Byroja Kosovare e sigurimeve

www.bks-ks.org
Tel: +381 (0) 38 227 060
Fax: +381 (0) 38 245 110
Email: info@bks-ks.org

Forumi i Kosovës për siguri në rrugë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

# KUJDES SE PO RRËSHQET!!!




**Pajisjet dimërore janë te obliguara me ligj t'i posedoni në mjetin tuaj**

## Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor nr. 05/L-088

**SHTATOR 2015/2016**

**- 13 apo – 57 %**

**TETOR 2015/2016**

**- 5 apo – 31 %**

**NËNTOR 2015/2016**

**- 4 apo – 33 %**

**DHJETOR 2015/2016**

**1 apo 11 %**

**JANAR-DHJETOR 2015/2016**

**- 19 apo – 15 %**

# “ZERO FATALITETE”

“Synim me të cilin të gjithë mund të jetojmë”


TAXI

# FALEMINDERIT

**Major Jeton REXHEPI**
Drejtor i Drejtorisë për Preventivë në Komunikacionin Rrugor